

KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

KOLEGJI "PJETËR BUDI"

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Vlorë, Republika e Shqipërisë

dhe

KOLEGJI "PJETËR BUDI"

Prishtinë, Republika e Kosovës

Në mënyrë që të zgjerojnë bashkëpunimin ekzistues arsimor, shkencor dhe kulturor, Kolegji Universitar "Reald" në Vlorë dhe Kolegji "Pjetër Budi" në Prishtinë i bashkohen protokollit të mëposhtëm mbi bashkëpunimin arsimor dhe kulturor.

Të dy institucionet do të angazhohen që të bashkëpunojnë në fushat e arsimit, kërkimit shkencor dhe kulturës me interes të përbashkët. Për aq sa është e mundur, të dy institucionet do të inkurajojnë kontaktet dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet anëtarëve të stafit akademik të fakulteteve, departamenteve, njësive kërkimore dhe studentëve.

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Fushat e veçanta të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve përfshijnë:

1. Shkëmbime të stafit akademik ndërmjet fakulteteve;
2. Shkëmbime të studentëve;
3. Aktivitete dhe leksione të përbashkëta;
4. Pjesëmarrje në seminare dhe takime akademike;
5. Shkëmbime të materialeve akademike të publikuara dhe informacion të tjera;
6. Programe të veçanta akademike afatshkurtra.

I. SHKËMBIME TË STAFIT AKADEMIK NDËRMJET FAKULTETEVE

1. Pavarësisht se shpenzimet e udhëtimit dhe kostot e jetesës së stafit akademik dhe kërkuesve shkencor nuk kompensohen nga institucioni pritës, në rastet kur do të kërkohet mbështetje financiare shtesë, atëherë kjo kërkesë do të vlerësohet në baza individuale.
2. Institucioni pritës duhet të ofrojë një ambient zyre dhe të mundësojë aksesin në librari dhe në qendrat e tjera për stafin akademik dhe për kërkuesit shkencorë.
3. Vetëm nëse është rënë dakord ndryshe, të gjitha shkëmbimet bazohen në reciprocitet brenda të njëjtit vit akademik.
4. Shkëmbimet ndërmjet stafit akademik/kërkuesve shkencorë, zakonisht do të zgjasin një ose dy semestra, qëndrimet më të shkurtra janë të mundshme vetëm në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.
5. Shkëmbimet ndërmjet stafit akademik/kërkuesve shkencor duhet të aprovohen nga institucioni pritës.
6. Secili profesor paguhet nga institucioni në të cilin është punësuar me kohë të plotë gjatë periudhës së shkëmbimit dhe pagesa për projekte të veçanta do të jetë në varësi të negociatave të veçanta.
7. Ngarkesat e mësimdhënies, orët e punës dhe kushtet do të jenë zakonisht në përputhje me rregullat dhe praktikat e aprovuara të institucionit pritës, në varësi të negociatave dhe marrëveshjeve të mëparshme.
8. Protokolli ndërmjet Kolegjit Universitar "Reald" dhe Kolegjit "Pjetër Budi" mund të jetë në çdo fushë të përshtatshme akademike në secilin institucion, në varësi të një aprovimi paraprak nga administrata e institucionit pritës.

II. SHKËMBIME NDËRMJET STUDENTËVE

1. Aplikime të tilla respektohen nga Kolegji Universitar "Reald" Vlorë dhe nga Kolegji "Pjetër Budi" në Prishtinë mbi parimin e reciprocitetit brenda të njëjtit vit akademik.
2. Studentët e shkëmbyer do të pranohen si specializantë për një periudhë që zgjat një ose dy semestra (vjeshtë dhe/ose pranverë), dhe për një periudhë maksimale prej një viti akademik.
3. Studentët e shkëmbyer mund të ndjekin kurse për të marrë kredite dhe institucioni pritës duhet të lëshojë një transkripto në të cilin shënohen notat e marra për studentët e shkëmbyer në përputhje me të njëjtat rregulla dhe rregullore që zbatohen për studentët e tij që po diplomohen.
4. Për aq kohë sa respektohet parimi i reciprocitetit, pagesa e shkollimit dhe tarifat duhet të përjashtohen nga institucioni pritës për studentët e shkëmbyer.
5. Studentët e shkëmbyer duhet të rekomandohen nga institucioni që e dërgon dhe duhet të ndjekë rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni pritës.
6. Shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës për studentët e shkëmbyer mbulohen nga vetë studentët, nga një sponsor ose nga institucioni që e dërgon.
7. Një dokument mbi Mbështetjen Financiare mbi shpenzimet e jetesës duhet t'i paraqitet paraprakisht institucionit pritës nga studenti/studentët e shkëmbyer.

III. ZHVILLIMI I KONFERENCAVE SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi ndërinstitucional përfshin edhe fusha të tjera të edukimit akademik dhe kërkimit shkencor, si:

1. Shkëmbime të stafëve akademike;
2. Promovime për programe të përbashkëta studimi;
3. Organizime të përbashkëta për kurse, vizita studimore, workshop-e dhe seminare;
4. Projekte të përbashkëta kërkimore;
5. Organizim i përbashkët i konferencave shkencore, në Vlorë dhe në Prishtinë;
6. Të tjera forma bashkëpunimi që mund të jenë më interes të përbashkët.

IV. PËRTËRITJA, PËRFUNDIMI DHE NDRYSHIMET

1. Këto standarde duhet të autorizohen nga përfaqësuesit zyrtarë të të dy universiteteve në dy kopje dhe secila palë do të mbajë një kopje.
2. Me përjashtim të rasteve ku është specifikuar dhe parashikuar me marrëveshje të veçantë, ky Memorandum nuk do të vendosë detyrime financiare mbi institucionin pritës.
3. Të dy institucionet do të vlerësojnë secilin aplikim në përputhje me elementët që lidhen me zbatimin e programeve të shkëmbimit bazuar në këtë Memorandum.
4. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së këtij Memorandumi është pesë vite. Më pas mund të përtëritet, vetëm nëse njëra nga palët dërgon paraprakisht me shkrim gjashtë muaj më parë kërkesën për ta përfunduar. Ky Memorandum, do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dy institucioneve.
5. Pikat, të cilët nuk janë të mbuluar nga Memorandumi, mund të përcaktohen dhe negociohen në mënyrë të veçantë nga të dy institucionet, pa qenë e nevojshme të shfuqizojnë këtë Memorandum.

Ky Memorandum është nënshkruar në 4 kopje, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën angleze, të cilat kanë të njëjtën vlefshmëri. Secila palë mban një kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe një kopje origjinale në gjuhën angleze të nënshkruar të Protokollit.

Prof. Dr. Spiro CAUSHI

Rektor

Kolegji Universitar "Reald", Vlorë

Nënshkruar në Prishtinë, më datë 19.05.2019




Adresa: Rr. "Zahir Pajaziti", Lagjia "24 Maj"
AL-9401, Vlorë – Shqipëri
Web site: www.unireald.edu.al
E-mail: universitetireald@yahoo.com

Prof. Ass. Dr. Orhan ÇEKU

Rektor

Kolegji "Pjetër Budi", Prishtinë

Orhan Çeku



Adresa: Rr. "Gazmend Zajmi", nr. 33
Lagjia "Aktash I", Prishtinë, 1000
Web site: www.pjeterbudi-edu.com
E-mail: info@pjeterbudi-edu.com